REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 269/1 Prot

Maliq, më 04.05.2026

VENDIM

Nr 58, datë 30.04.2026

PËR
MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË PËR STREHIM

Bazuar ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, neni 8 neni 9 pika 1, nënpika 1.1 gërma "b", neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*" gërma "c", ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", VKM nr.453, datë 03.07.2019 "*Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët , me kredi të lehtësuara nga shteti*" ndryshuar me vendimin nr. 268, datë 29.4.2022, VKM nr.301 datë 15.4.2020 "*Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët*", VKB nr. 139, datë 26.11.2025 "*Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë*", VKB nr.91 datë 31.08.2023 për "*Miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në bashkinë Maliq*", Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.158 datë 26.03.2024 "*Për ngritjen e komisionit të strehimit pranë bashkisë Maliq*" si dhe Vendimin nr.02 datë 14.04.2026 mbi "Miratimin e listës së përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim" të Komisionit të Strehimit bashkia Maliq, Këshillit i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë familjen me kryefamiljar Z. , si përfitues të programit Subvencioni i Interesave të Kredisë për Strehim, me 60% të vlerës së apartametit që i takon, sipas tabelës nr.1 bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Strehimit, Bashkia Maliq.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar.

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 04.05.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Tabela nr.1 lista e përfituesve të programit të Strehimit Social, Subvencioni i Interesave të Kredisë

Nr	Emri/Atësia /Mbiemri *(kryefamiljari)*	Pikë	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e Strehimit (shkronja "a", e nenit 16)	Kushtet familjare (shkronja "b", e nenit 16)	Kushtet sociale (shkronja "c", e nenit 16)	Të ardhurat mujore neto të familjes/lekë	Punësimi	Kredia Maksimale që përfiton	Kontakt
1	[redacted]	13	5	3+1	Banesë e mbipopulluar		PAK	79761 lekë/muaj	Shtet	1.701.360	0695353269

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 04.05.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ